



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 14 tetor 2024  
Nr. ref.:RK 2556/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI143/24**

Parashtrues

**Shemsedin Zumeri**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml.nr.220/2024, të 12 prillit 2024,  
të Gjykatës Supreme të Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Bajram Ljatifi, gjyqtar  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Shemsedin Zumeri me vendbanim në Gjilan (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Gazmend Zymberi, avokat në Komunën e Gjilanit.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml.nr. 220/2024], të 12 prillit 2024, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktvendimin [PN.nr.1604/2023], e 29 dhjetorit 2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) si dhe Aktvendimin [PKR.nr.3/2021], e 9 nëntorit 2023, të Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një Proces të Rregullt) dhe nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr.01/2023 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 4 korrik 2024, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) e pranoi më 8 korrik 2024.
6. Më 15 korrik 2024, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr.GJR.KI143/24], caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi Gjyqtar raportues, dhe përmes Vendimit [Nr.KSH.KI143/24], Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 24 korrik 2024, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të shkresës, të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim, të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës.
8. Më 14 gusht 2024, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.
9. Më 15 gusht 2024, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës duke i dorëzuar një kopje të kërkesës.
10. Më 01 tetor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## Përmbledhja e fakteve

### *Procedura përkitazi me dënimin e parashtruesit të kërkesës për veprë penale*

11. Nga shkresat e lëndës rezulton se përmes Aktgjykimit [PKR.nr.03/2021], të 16 prillit 2021, të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK), dhe ishte dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjet e 8 (tetë) muaj, dhe me dënim me gjobë në shumën prej 6000€ (gjashtëmijë euro). Në dënimin e shqiptuar me burgim, parashtruesit të kërkesës i ishte llogaritur edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit prej 24 nëntorit 2018 deri më 11 janar 2019. Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Themelore ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.215/2021], të 19 tetorit 2021.

### *Procedura përkitazi me kërkesën për rishikim të procedurës penale*

12. Më 16 tetor 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për rishikimin e procedurës penale të përfunduar me Aktgjykimin [PKR.nr.03/2021], e 16 prillit 2021, të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, me arsyetimin se janë zbuluar fakte të cilat së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojnë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij më të butë. Në këtë kërkesë po ashtu theksohej se në procesin gjyqësor ndaj tij, me asnjë provë të vetme nuk ishte vërtetuar fakti se i njëjti ka pasur qëllim që të blejë, të posedoj, të shesë apo të shpërndaj lëndë narkotike por përkundrazi i lartcekuri as nuk e kishte ditur se çka përmbante çanta e gjetur në shtëpinë e tij dhe se nuk kishte qenë i vetëdijshëm për asnjë nga tiparet e veprës penale. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se trupi gjykues ishte mbështetur në prova të pa pranueshme për marrjen e vendimit për shpalljen fajtor të tij dhe se vetëm provat se është gjetur çanta në shtëpinë e të tij nuk vërteton faktin se i njëjti e kishte ditur përmbajtjen e saj. Andaj, ai i kishte propozuar gjykatës që (i) të lejohet rishikimi i procedurës penale; (ii) të ndërpritet ekzekutimi i dënimit; dhe (iii) të caktohet shqyrtimi gjyqësor.
13. Më 1 nëntor 2023, Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda përmes shkresës [PP.I.nr.251/2018], kishte kërkuar që të refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale të përfunduar me Aktgjykimin e formës së prerë [PKR.nr.3/2021], të 16 prillit 2021, për shkak se i njëjti nuk ka arritur të siguroj ndonjë fakt ose provë të re e cila qoftë në vetvete ose së bashku me provat e tjera ka të ngjarë që të arsyetojnë shqiptimin e dënimit më të butë për parashtruesin e kërkesës, e aq më pak të arsyetojnë pafajësinë e tij.
14. Më 9 nëntor 2023, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PKR.nr.3/2021], refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale, duke arsyetuar se (i) nuk ekzistojnë asnjë nga arsyet ligjore për rishikimin e procedurës penale, pasi parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi apo provë konkrete, e cila do të arsyetonte pafajësinë e tij; (ii) nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të të dënuarit se aktgjykimi mbi dënimin e tij është mbështetur në prova të pa pranueshme për marrjen e vendimit për shpalljen e tij fajtor.
15. Kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit me pretendimin se, mes tjerash, Gjykatës Themelore i kemi ofruar mjaftueshëm fakte se Aktgjykimi për shpalljen fajtor të tij ka qenë i kundërligjshëm dhe se trupi gjykues është mbështetur në prova të papranueshme kur ka vendosur për dënimin e tij.

16. Më 8 dhjetor 2023, Prokuroria e Apelit me parashtresën [PPN/I.nr.593/2023], propozoi që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës.
17. Më 29 dhjetor 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.nr. 1604/2023], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktvendimin [PKR.nr.3/2021], të 9 nëntorit 2023, të Gjykatës Themelore, duke mbështetur arsyetimin e Gjykatës Themelore.
18. Më 26 mars 2024, parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme duke pretenduar, mes tjerash, se Gjykata Themelore me rastin e dënimit të tij ishte mbështetur vetëm në një provë materiale dhe ka anashkaluar disa prova tjera materiale, përderisa Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit me rastin e shqyrtimit të kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale nuk kanë urdhëruar gjurmimin e provave të propozuara për të konstatuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
19. Më 3 prill 2024, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes shkresës [KMLP .II.nr.124/2024], propozoi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
20. Më 12 prill 2024, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.220/2024], refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit [PKR.nr.3/2021], të 9 nëntorit 2023, të Gjykatës Themelore, dhe Aktvendimit [PN.nr.1604/2023], të 29 dhjetorit 2023, të Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se nuk është paraqitur propozim për ndonjë provë të re që do ta bënte të justifikueshëm rishikimin e procedurës penale, pasi dispozita e nën-paragrafit 1.3 të paragrafit 1 të nenit 423 (Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë) i Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm: KPP) mundëson rishikimin e procedurës penale në rast se: *“zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale”*.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e kontestuara janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese, konkretisht të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një Proces të Rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 4 të Protokollit nr. 7 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të KEDNJ-së.
22. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës ngrit pretendim sipas të cilit thekson se bazuar në legjislacionin procedural penal, si dhe praktikën procedurale penale, konsideron që përveç konstatimit të Gjykatës Supreme në kërkesën e rishikimit të procedurës penale në favor të të dënuarit, pos tjerash, si shkak për lirim të tij mund të theksohen faktet vendimtare që tregojnë se një vepër nuk është vepër penale ose se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij sipas nenit 25 (Lajthimi faktik) të KPRK-së.
23. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që nuk ekzistojnë arsyet ligjore që të refuzohet rishikimi, në rastet kur evidentohen mangësitë themelore të cilat e cenojnë Aktgjykimin fajësues, e në rastin e tij ku evidentohet se nuk është administruar fare prova vendimtare - Daktiloskopia nga ekspertiza e Agjencisë Kosovare të Forenzikës, dhe në anën tjetër me asnjë provë të vetme nuk janë vërtetuar elementet subjektive të kryerësit të veprës penale.

24. I njëjti gjithashtu thekson se në bazë të legjislacionit procedural penal, bazë për rishikim në favor të të dënuarit mund të jenë faktet vendimtare, të cilat janë shkak për përjashtimin e përgjegjësive penale, e drejtë kjo e garantuar ndaj çdo personi të dënuar përmes nën-paragrafi 1.3, paragrafi 1 i nenit 423 të KPP-së, dhe rrjedhimisht edhe me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 4 paragrafi 2 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së.
25. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatoj që vendimet e kontestuara nuk janë në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 4 të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) të shpallë të njëjtat të pa pavlefshme; dhe (iv) ta kthejë çështjen në rivendosje në Gjykatën Themelore në Gjilan.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbente rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t’u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*
- 6. Ndihma juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.*
- 7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.”*

## **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

#### **Neni 6**

#### **(E Drejta për një proces të rregullt)**

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet*

*nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.  
[...]*

## **Protokolli Nr. 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

### **Neni 4**

#### **(E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë)**

*1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti.*

*2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë.*

*3. Asnjë derogim nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.*

## **Kodi nr. 04/l-123 i Procedurës Penale**

### **Neni 419**

#### **Dispozita e përgjithshme**

*“Procedura penale e përfunduar me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet me kërkesën e personave të autorizuar vetëm në rastet dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod”.*

### **Neni 423**

#### **Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë**

*“1. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm nëse:*

*1.1. provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklaram të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit;*

*1.2. provohet se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore;*

*1.3. zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojnë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale;*

*1.4. personi për të njëjtën vepër është gjykuar disa herë ose kur disa persona janë dënuar për vepër të njëjtë të cilën ka mund ta kryejë vetëm një person ose disa prej tyre; ose*

*1.5. në rastin e dënimit për vepër penale në vazhdim ose vepra tjera penale të cilat sipas ligjit përfshijnë disa veprime të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk ka kryer veprimin që është përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit.*

*[...]*

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

28. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

Neni 49

(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.*

29. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 220/2024], e 12 prillit 2024, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
30. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë), përkatësisht me paragrafin (2), të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34

(Kriteret e pranueshmërisë)

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

(d) *Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.*

[...]

(2) *Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk e mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

[...]

(3) *Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:*

[...]

(b) *Kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;*

31. Në lidhje me këtë Gjykata fillimisht vëren se në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës ishin zhvilluar 2 (dy) procedura:
- (i) procedura penale me të cilën parashtruesi i kërkesës përmes Aktgjykimit [PKR.nr.03/2021], të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, të 16 prillit 2021, ishte shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, i cili Aktgjykim ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit; dhe
  - (ii) procedurën për rishikimin e procedurës penale të lartcekur, e cila kishte kulmuar me Aktgjykimin [Pml.nr.220/2024], e 12 prillit 2024, të Gjykatës Supreme me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit [PN.nr.1604/2023], të 29 dhjetorit 2023, të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimit [PKR.nr.3/2021], të 9 nëntorit 2023, të Gjykatës Themelore.
32. Parashtruesi i kërkesës konteston para Gjykatës vetëm procedurën e dytë, përkatësisht procedurën për rishikimin e procedurës penale, duke kontestuar Aktgjykimin [Pml.nr.220/2024], e 12 prillit 2024, të Gjykatës Supreme, duke pretenduar se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ-së, dhe nenin 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së.
- (i) ***Pretendimet përkitazi me shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së***
33. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që për sa i përket rishikimit të procedurës penale, parashtruesi pretendon se nuk ekzistojnë arsyet ligjore që të refuzohet rishikimi i procedurës penale pasi në rastin e tij ishin evidentuar mangësi themelore në procedurën përmes së cilës ai është shpallur fajtor dhe se nuk janë administruar fare prova vendimtare, siç është daktiloskopia nga ekspertiza e Agjencisë Kosovare të Forenzikës. I njëjti gjithashtu thekson se në bazë të legjislacionit procedural penal, bazë për rishikim në favor të të dënuarit mund të jenë faktet vendimtare, të cilat janë shkak për përjashtimin e përgjegjësisë penale.
34. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se lidhur me kërkesën për rishikim të procedurës penale, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, gjykatat e rregullta kishin vendosur refuzimin e saj. Gjykata thekson se gjykatat e rregullta në procedurën sipas kërkesës për rishikim të procedurës penale vendosin vetëm lidhur me çështjen nëse kërkesa për rishikim të procedurës penale plotëson kushtet procedurale për miratimin e saj, dhe jo për “*ndonjë aktakuzë*” të parashtruesit të kërkesës brenda kuptimit të së drejtës për gjykim të drejtë të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës: [KI63/21](#), me parashtrues *Hysen Metahysa*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 nëntorit 2021,



paragrafi 72; dhe [KI34/23](#), me parashtrues *Veton Syla*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 gushtit 2023, paragrafi 4; shih gjithashtu dhe rastet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: [Bochan kundër Ukrainës, \(nr. 2\)](#), nr. 22251/08, Aktgjykim i 5 shkurtit 2015, paragrafi 44 dhe [Moreira Ferreira kundër Portugalisë \(nr. 2\)](#), nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafët 60-61).

35. Përveç kësaj, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të saj dhe të Gjykatës për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), neni 6 i KEDNJ-së nuk është i zbatueshëm në procedurat për përsëritjen e ndonjë rasti, ngase një person dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rasti të tij, i njëjti gjatë kësaj procedure nuk është "i akuzuar për ndonjë vepër penale" në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, [Fischer kundër Austrisë](#), nr. 27569/02, Vendim mbi pranueshmërinë, i 6 majit 2003; shih gjithashtu rastin e Gjykatës [KI34/23](#), cituar më lartë, paragrafi 49).
36. Gjykata, pikërisht duke pasur parasysh këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës në kontekstin e garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, konstaton se procedura gjyqësore e përmendur në të cilën parashtruesi i kërkesës i bazon pretendimet e tij ankimore kishte të bënte vetëm me vlerësimin e përmbushjes së kërkesave procedurale të cilat duhet t'i përmbushë një kërkesë për rishikim të procedurës penale, në mënyrë që të jetë e pranueshme, dhe kështu rasti do të rihapej për shqyrtim dhe vlerësim në procedurën e përsëritur.
37. Prandaj, Gjykata duke pasur parasysh përmbajtjen e procedurës gjyqësore në të cilat parashtruesi i ka mbështetur pretendimet e tij ankimore për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën e vet gjyqësore, sipas së cilës neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës (shih, rastet e Gjykatës: [KI07/17](#), *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 64; [KI80/15](#), [KI81/15](#) dhe [KI82/15](#), *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31; [KI167/22](#), parashtrues *Fatos Kakeli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 marsit 2023, paragrafi 63; [KI34/23](#), cituar më lartë, paragrafi 52; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së, [Oberschlick kundër Austrisë](#), nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, [Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2011).
38. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me procedurën gjyqësore të zhvilluar nga gjykatat sipas kërkesës së tij për rishikimin e procedurës shpallet e papranueshme, për shkak se është e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, siç përcaktohet me paragrafin 7 të nenin 113 të Kushtetutës dhe rregullin 34 (3) (b) të Rregullores së punës.

**(ii) Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenin 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së**

39. Gjykata edhe përkitazi me shkeljen e nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar.
40. Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më

saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së [Kemmachev kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykim, i 24 nëntorit 1994, paragrafi 44 [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Vendimi i 31 majit 2005, paragrafi 55; [Mentzen kundër Letonia](#), Kërkesa nr. 71074/01, [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendimi i 25 shtatorit 2008, dhe rastet e Gjykatës [Kl04/21](#), parashtruese [Nexhmije Makolli](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 13 prillit 2021, paragrafi 26; [Kl107/21](#), parashtrues [Ramiz Hoti](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, paragrafi 53; dhe [Kl05/23](#), parashtrues [Branislav Gajin](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2024, paragrafi 51).

41. Në rastin konkret, përkitazi me pretendimit e tij se gjykatat e rregullta duke refuzuar kërkesë e tij për rishikimin e procedurës penale, kanë cenuar nenin 4 të Protokollit nr. 7 [E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë] të KEDNJ-së, Gjykata thekson se sipas nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së (i) askush nuk mund të ndiqet ose dënohet dy herë për të njëjtën vepër penale për të cilën është dënuar ose liruar përfundimisht; përveç nëse rasti (ii) rihapet në përputhje me ligjin dhe procedurën penale në rast se ka fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose ka pasur një mangësi themelore në procedimet e mëparshme. (shih rastin e Gjykatës [Kl0114/23](#), [Kl0192/23](#), [Kl0227/23](#) dhe [Kl0229/23](#), raste të bashkuara, parashtrues: [Gjykata Supreme e Kosovës](#), Vlerësim i kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4, paragrafit 4 të nenit 432, dhe paragrafit 2 të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Nr.08/L-032, Aktgjykim i 15 majit 2024, paragrafi 149).
42. Në këtë kontekst, neni i lartcekur i KEDNJ-së nuk përcakton detyrimin për gjykatat e rregullta për të lejuar rishikimin e procedurës penale që ka përfunduar, por mundëson që përjashtimisht, procedura penale e përfunduar me vendim përfundimtar të mund të rishikohet nëse plotësohen kushtet e caktuara, mes tjerash, në rast se ka fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, gjë që në rastin e parashtruesit, ky nuk ishte rasti. Kjo pasi, (i) parashtruesi i kërkesës nuk ishte ndjekur apo gjykuar dy herë për të njëjtën vepër; dhe (ii) sipas gjykatave të rregullta, në rastin e parashtruesit të kërkesës, nuk kishte ndonjë provë të re që do ta bënte të justifikueshëm rishikimin e procedurës penale, sipas dispozitave të nën-paragrafit 1.3 të paragrafit 1 të nenit 423 (Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë) të KPP-së.
43. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, janë pretendime “të pambështetura apo paarsyetuara”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (2) dhe (3) (b) si dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 01 tetor 2024, njëzëri:

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- IV. TË KONSTATOJË që ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

  
Jeton Bytyqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



  
Gresa Caka-Nimani